

Auditimi

Bekim Berisha, Ph.D., CPA

Literatura:

- ✓ **Manuali i Deklaratave të Auditimit, dhënjes së sigurisë dhe etikës. (IEKA)**
- ✓ **Louwers/Ramsay/Sinason/Strawser, Auditing & Assurance Services, 2th Edition.**
- ✓ **Whittington and Pany, botimi i 17'te, Bazat e Auditimit, 2010. 1th Edition.**

Syllabusi

1. ZHVILLIMI HISTORIK I PROFESIONIT TË AUDITIMIT
2. RREGULLATIVA NË PROFESIONIN E AUDITIMIT
3. STANDARDET E ETIKËS PROFESIONALE
4. NJOHJA ME KONCEPTET THEMELORE TË AUDITIMIT
5. PLANIFIKIMI I PROCESIT TË AUDITIMIT
6. KONTROLLI I BRENDSHËM

Syllabusi

7. TESTET E KONTROLLIT
8. MOSTRIMI NË AUDITIM
9. RISHIKIMI DHE PËRFUNDIMI I AUDITIMIT
10. RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Kriteret e vlerësimit

VIJIMI	10 %
KOLLOKVIJUMI – 1	20 %
KOLLOKVIJUMI – 2	20 %
PROVIMI FINAL	50 %
Gjithsej:	100 %

Provimi konsiderohet i kaluar nëse studenti arrijnë 60% të pikëve

Formati i provimit

Perpiluesi: _____ X _____

Formati i provimit

Pikë

Pyetja 1 Zbatimi i procedurave të auditimit një skenar _____ 30 p.

Pyetja 2 Pyetje të shkurta faktike nga SNA dhe në fusha të tjera të bazuara në njohuri _____ 10 p.

Pyetja 3 Pyetje me skenarë të shkurtër praktik të bazuara në tema të tilla si: auditimit intern, vlerësimi i riskut, planifikimi, kontrolli, dëshmitë, përfundimi dhe raportimit _____ 60 p.

Gjithsej: _____ 100 p.

Çka kërkohet nga Ju?

- T'i ndiqni ligjeratat rregullisht
- Të përgaditeni paraprakisht për ligjerata,
- Të keni njohuri për kontabilitet financiar,
- Të keni njohuri për raportim financiar,
- Të përdorni këto njohuri duke i aplikuar në provim,
- Të keni aftësi/shkathtësi për të shpjeguar idet kyçe,
- Të ofroni përkufizime të thjeshta duke shpjeguar se pse është zhvilluar një qasje e tillë,
- Përgjigjet tuaja të jenë relevante me skenarin e pyetjes

Çka kuptojmë me auditimin ekstern?

- Fjala “auditor” rrjedhë nga latinishtja dhe në përkthim don të thotë “dëgjues”
- Këta individë në Romën e lashtë kishin si qëllim të dëgjonin taksapaguesit në procesin e administrimit të pronave.
- Veprimtaria e auditimit fillon që nga koha e Babilonisë së lashtë (rreth viteve 3,000 p.e.s.). Më herët auditimi u zhvillua në Kinë, Greqinë e Lashtë dhe në Perandorinë Romake.#



Çka kuptojmë me auditimin ekstern?

- Auditimi i parë i jashtëm është kryer në vitin 1720 nga një kontabilist publik i pavarur (auditues i pavarur) i quajtur Charles Shnell.
- Ai ju kushtua skandalit të ndodhur në kompaninë britanike South Sea Bubble (Fluska e detit të jugut) (1711-1850), të cilës i ishte dhënë e drejta ekskluzive të tregtonte në Amerikën e Jugut bazuar në një traktat të Anglisë me Spanjën. Në librat e llogarive të saj u zbuluan regjistrime fiktive.



Çka kuptojmë me auditimin ekstern?

- Për shkak se vlera gjithsej e tregut e kompanisë South Sea Bubble, tejkalonte vlerën e të gjithë thesarit të Anglisë, falimentimi i saj shkaktoi një ngjarje publike me konsekuenca të mëdha për të gjithë ekonominë e Anglisë.
- Mundë të thuhet se ishte kjo ngjarje që vendosi precedentin në historinë e auditimit.
- Auditimi modern daton së bashku me fillimin e zhvillimit të korporatave moderne (shoqërive tregtare aksionare) pra, atëherë kur vije deri te ndarja e pronësisë nga menaxhmenti (drejtimi).



Zhvillimi i auditimi në Kosovë

Profesioni i auditimit të jashtëm në Kosovë është i ndërlidhur me përkufizimin e sistemit të raportimit financiar, i cili gjithashtu ndahet në dy periudha:

- Periudha deri në vitin 1999, dhe
- Periudha pas vitit 1999

Auditimi dhe angazhime të tjera të sigurisë

Auditimi ekstern është një lloj i *angazhimeve për siguri* i cili kryhet prej një audituesi me qëllim të dhënjes së një opinionimi të pavarur mbi një komplet të pasqyrave financiare.



Është e rëndësishme të ceket se një auditor nuk është garanci për korrektësi dhe saktësi.



Llojet e shërbimeve të sigurisë

1. Auditimi ekstern
 - a) Statutor, dhe
 - b) Jo-statutor

2. Rishikimet
3. Procedurat e rëna takord
4. Përpilimet
5. Shërbimet e auditimit intern
6. Auditimet e performancës

Objektivat e auditimit ekstern

- T'i mundësojë audituesit shprehjen e një opinioni mbi faktin nëse p.f. janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi.

(japin një pamje të drejtë e të sinqertë)

- Pra, qëllimi i një auditimi është t'i mundësojë auditorëve të japin një opinion mbi pasqyrat financiare



Auditimet ligjore dhe jo-ligjore

Auditimet ligjore/statutore janë ato auditime që kërkohen sipas legjislacionit mbi statutin ligjor të shumë ndërmarrjeve, përfshirë Sh.P.K.-të. (psh.OH, Bizneset që mirren me investime, unionet tregtare). (*Përfitimet-opinionit, rekomandimet e SK dhe KB*)

Auditimet jo-ligjore kryhen sipas kërkesës së pronarëve, anëtarëve, trustet, organizmat profesional dhe qeverisës, dhe jo se kërkohen me ligj.





Përparësitë:

- Stabilizim i marrëdhënjëve midis partnerëve,
- Pranueshmëria nga autoritetet tatimore
- Shitja e biznesit
- Negociatat për kredi,
- Kredi overdraft
- Siguria e Partnerit jo aktiv

Studim rasti

Përgjegjësia dhe administrimi





Përgjegjësia dhe administrimi

Audituesi ofron siguri për aksionarët dhe palët e tjera të interesuara për p.f. të një kompanie se ai është i **pavarur** dhe i **paanshëm**.


Përgjegjësia është cilësia ose gjendja e qenies përgjegjës, të pritët prej dikuj të justifikojë veprimet dhe vendimet e marra.

Administrimi është menaxhimi (përdorimi) i pasurive të një personi tjetër.

Agjentët njerëz të punësuar për të kryer një shërbim specifik.
(menaxhimi i biznesit)

Për qfarë janë përgjegjës drejtorët?

Për investimet e aksionerëve.





Dhënja e sigurisë

Një **angazhim për siguri** është një angazhim në të cilin një auditues shpreh një konkluzion të ndërtuar në mënyrë të tillë që të rrisë shkallën e besimit të përdoruesve të synuar të tjerë nga pala përgjegjëse rreth përfundimeve të vlerësimit ose matjes së një çështjeje të caktuar kundrejt kritereve të paracaktuar.

E rëndësishme: Komunikimi midis drejtorëve dhe aksionarëve për:

- Pagesën e drejtorëve, supozimin e vazhdimsisë dhe menaxhimin e riskut



Niveli i siguris

Siguria ka të bëjë me faktin se sa i mbushet mendja audituesit për faktet e pohimeve të bëra nga njëra palë për t'u përdorur nga pala tjetër, janë të besueshme.

Për të dhënë siguri, audituesi duhet të:

- Vlerësojë riskun
- Planifikojë procedurat
- Zbatojë procedurat
- Vlerësojë rezultatet
- Shprehë një opinion

Niveli i siguris

Se qfarë shkalle të siguris ofron audituesi, varet nga natyra e angazhimit dhe procedurat e zbatuara.

Llojet e angazhimeve për siguri janë:

1. Angazhimet e auditimit
2. Angazhimet për rishikim/Revizion
3. Procedurat e rëna dakord
4. Angazhimet e përpilimit.





Llojet e shërbimeve të sigurisë

Objektivi i një angazhimi për *rishikim* është t'i mundësojë një audituesi që duke u bazuar mbi bazat e procedurave të cilat nuk ofrojnë gjithë evidencën që do të kërkohej në një auditim, të tregojë nëse i ka tërhequr vëmendjen ndonjë gjë e cila e bën auditorin të besojë se pasqyrat financiare nuk janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me një kornizë të identifikuar të raportimit financiarë.



Llojet e shërbimeve të sigurisë

Auditimi intern është një aktivitet i vlerësimit ose monitorimit i themeluar brenda një entiteti në formën e një shërbimi të dhënë ndaj entitetit.

Funksionet e tij, midis gjërave të tjera, janë ekzaminimi, vlerësimi dhe raportimi ndaj menaxhmentit dhe drejtorëve i përshtatshmërisë dhe efektivitetit të përbërësve dhe të sistemeve të kontabilitetit dhe të kontrollit të brendshëm.



Siguria dhe raportet

Auditesit ekstern japin një opinion mbi **të vërtetën** dhe **të**

Sinqertën mbi p.f.# kjo nenkupton se p.f. mbështeten në:

E vërtetë – informacionet janë **faktike** dhe në përputhje me realitetin, standardet e kërkuara dhe ligjet përkatëse.

E sinqertë - Informacionet nuk përmbajnë asnjë lloj paragjykimi dhe **anësie**, dhe në përputhje me standardet dhe rregullat e pritura.

Auditimi i jep përdoruesve të p.f.një siguri të arsyeshme mbi vërtetësinë dhe sinqeritetin e p.f. Raporti i auditimit nuk garanton faktin se p.f.janë të sakta, por që janë të vërteta dhe të sinqerta brenda për brenda një hapësire të arsyeshme për gabime.



Kufizimet e auditimit

Audituesi nuk jep siguri absolute për shkakë të kufizimeve të trashëguara të auditimit, por vetëm siguri të arsyeshme mbi faktin se p.f. nuk përmbajnë gabime materiale.

Meqenëse audituesi përdor gjykimin e vet profesional në lidhje me përzgjedhjen e procedurave të auditimit për të nxjerrë përfundime, është kufizim për mos dhënje të sigurisë absolute.

Për shkak se gabimet e rëndësishme për përdoruesit ende mundë të jenë prezente në p.f., auditimi duhet planifikuar me skepticizëm profesional.



Materialiteti

Materialiteti është një shprehje e rëndësisë relative, ose të një çështjeje të veçantë në perspektivën e p.f. në tërësi.

Një çështje është materiale nëse mungesa e saj influencon në mënyrë të arsyeshme vendimet e personave të cilëve iu drejtohet raporti i auditorit.

Materialiteti duhet të konsiderohet në kuadër të pohimeve individuale të zërave në p.f.

Materialiteti nuk mundë të përkufizohet nga ana matematike meqenëse ai përmban edhe aspekte cilësore edhe aspekte sasiore.



Pohimet e menaxhmentit

1. Ekzistenca
2. Plotësia
3. Të drejtat dhe obligimet/Pronësia
4. Vlerësimi dhe alokimi
5. Prezentimi dhe shpalosja



Procedurat për verifikimin e pohimeve

- Vërtetimi i pohimeve të bëra në pasqyrat financiare.
- Zhvillimi i synimeve të caktuara të auditimit lidhur me pohimet.
- Formulimi i procedurave audituese për vërtetimin e pohimeve.
- Dëshmimi i procedurave në programin e auditimit.



Pohimet e menaxhmentit

Sigurimi i dëshmimeve të auditimit bëhet përmes:

- INSPEKTIMI
- VËZHGIMI
- KËRKESA DHE VËRTETIMI
- PËRLLOGARITJA
- PROCEDURAT ANALITIKE

Shembull:

Për zhvillimin e procedurave për auditimin e huave afatgjata, audituesi duhet të ketë parasysh synimet vijuese të auditimit :

- Përcaktimi i përshtatshëmrisë së kontrolli intern për afat të gjatë;
- Vërtetimi se shpalosja e huave afatgjata është në përputhje me SNK (*prezentimi dhe shpalosja*);
- Vërtetimi i *ekzistencës* së huasë afatgjatë në fund të vitit;
- Vërtetimi i *pronësisë* së huasë afatgjatë në fund të vitit;
- Vërtetimi i *përmbushjes* se të gjitha huatë afatgjata janë të regjistruara në fund të vitit; dhe
- Vërtetimi i *vlerësimit* të duhur të të gjitha huave afatgjata në fund të vitit.

Shembull:

- Paraja
- Llogaritë e arkëtueshme
- Inventarët
- Patundshmëritë, Impiantet dhe Pajisjet
- Llogaritë e pagueshme



Skepticizmi profesional

Të besosh,
por ta vërtetosh!



Të bëhem i Çertifikuar

- Të çertifikohesh si Kontabilist
- Të çertifikohesh si Auditues
- Të keshë eksperiencë 3-vjeçare në auditim
- Ta marrësh çertifikatën e praktikës.



Përmbledhja e kapitullit

- Auditimi ekstern është një lloj i angazhimeve për siguri i cili kryhet prej një audituesi me qëllim të dhënjes së një opinioni të pavarur mbi një komplet të pasqyrave financiare.
- Auditimi ofron siguri për aksionerët dhe palët e tjera të interesuara për p.f. të një kompanie për arsye se ai është i pavarur dhe i paanshëm.
- Ky program ka të bëjë kryesisht me auditimet, rishikimet dhe sigurin e ofruar prej auditimeve interne.
- A.I.janë të punësuar si pjesë e sistemeve të kontrollit të organizatës. Përgjegjësitë e tyre përcaktohen prej organizatës dhe mundë të jenë të shumëllojshme.



Përmbledhja e kapitulli

- Raporti i audituesit mbi p.f.të kompanisë shprehë veten nëpërmjet të vërtetës dhe të sigurtës.

Në përgjithësi kjo nënkupton që p.f.:

- Mbështeten mbi fakte
- Janë të paanshme
- Pasqyrojnë thelbin tergtar të transaksioneve të biznesit
- Auditimi jep një siguri të arsyeshme mbi faktin se p.f. nuk përbëjnë gabime materiale.
- Niveli i siguris që jepet prej një profesionisti të paanshëm varet nga natyra e saj që po ushtrohet.

Pyetje?

